



ÇËSHTJET

KRYESORE:

• RASTI I TË RKUZËS

• VENDIMI I PARË GJYQËSOR NË SHQIPËRI PËR MUNGESËN E UJIT TË PIJSHËM –VISOKA

NË VIJIM:

AKSESI OSHK-VE NË GJYKATËN KUSHITETUESE 2

INICIMI I MISIONEVE MONITORESE NE SPITAL/PAYIONE PSIKIATRIKE 2

GJENDJE E RËNDË E PERSONAVE ME PROBLEME TË SHËNDËTTIT MENDOR NË IVSHB DHE IEVP ZAHARI 2

PROCESI I VETTINGUT 3

FENOMENI I EKSTREMIZMIT TË DHUNSHËM, TERRORIZMIT DHE RADIKALIZMIT 3

RESPEKTIMI I TË DREJTAVE TË AZILKËRKUESVE DHE EMIGRANTËVE NË SHQIPËRI 4

Komiteti Shqiptar i Helsinkit

BULETIN

NR. 3

QERSHOR-KORRIK 2018

Klinika Ligjore

RASTI I TËRKUZËS

“NDOTJA e ajrit dhe ujit”, masakra mjedisore që po i bëhet Kamzës

11 kilometra nga Tirana, në zonën e quajtur Zall Herr, ndodhet ky vend shkarkim mbeturinash i cili është shumë pranë lumit të Tërkuzës dhe shumë pranë banesave të kësaj zone. Mbetje spitalore, sende plastike, goma, qese, janë disa prej objekteve që mund të vihen re përgjatë rrjedhës së lumit. Komiteti Shqiptar i Helsinkit ka ngritur këtë shqetësim duke marrë shkas edhe nga ankesat e banorëve, të cilët e kanë të pamundur jetesën aty, por dhe për dëmin ekologjik që po ndodh në këtë zonë, duke u ardhur në ndihmë banorëve duke e çuar këtë çështje në gjykatë. Për më tepër: [ARTIKULL](#)



Jepet vendimi i parë gjyqësor në Shqipëri për mungesën e ujit të pijshëm për banorët e fshatit Visokë



Komiteti Shqiptar i Helsinkit (KShH) prej më shumë se një viti po ndjek në rrugë ligjore çështjen e mungesës së ujit të pijshëm për banorët e fshatit Visokë, Bashkia Mallakastër. Mungesa e ujit të pijshëm është e lidhur pandashmërisht me të drejtën themelore të jetës dhe të drejtën themelore për një jetë të qetë familjare dhe private. Ndaj për shkeljen e këtyre të drejtave, KShH ka filluar në emër të banorëve një proces gjyqësor, i cili po ndiqet dhe përfaqësohet nga avokatët e Klinikës Ligjore të organizatës tonë.



Procesi gjyqësor për kërkimin e të drejtave të shkelura të banorëve të Visokës zgjati rreth 8 muaj në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Vlorë, e cila, së fundmi konstatoi me vendim përfundimtar se mungesa e gjatë e ujit të pijshëm për këta shtetas ka shkaktuar dëm tek ata. Gjykata urdhëroi kompensimin e dëmit që i është shkaktuar banorëve, bashkërisht nga organet shtetërore përgjegjëse. Ky është vendimi i parë gjyqësor në Shqipëri i këtij lloji dhe përbën pjesërisht model pozitiv të mbrojtjes së drejtëpërdrejtë gjyqësore të individëve në nevojë. Për më shumë :

[ARTIKULL](#)

TRAJNIM MBI AKSESIN E OSHC-VE NË GJYKATËN KUSHTETUESE DHE PUBLIKIMI I MANUALIT PRAKTIK



Me ndryshimet që kanë ndodhur në ligjin për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese, qasja që u jepet OSHC-ve është më e madhe krahasuar me qasjen që kishin në sistemin e mëparshëm. Praktika ka zbuluar se OSHC-të nuk kanë kapacitetet të duhura për të vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese bazuar në misionin e tyre dhe të drejtat dhe liritë e grupeve të tyre. KSHH ka një eksperiencë shumë të mirë në përfaqësimin e rasteve individuale para kësaj gjykate, si dhe duke apeluar kundër kushtetutshmërisë së disa ligjeve dhe akteve të tjera normative para Gjykatës Kushtetuese. Komiteti Shqiptar i Helsinkit, në kuadër zbatimit të projektit “Përmirësimi i situatës së të drejtave të njeriut në Shqipëri nëpërmjet forcimit të shtetit të së drejtës – Klinika Ligjore XII”, mbështetur financiarisht nga organizata Civil Rights Defenders, me fonde të Qeverisë së Mbretërisë Suedeze, organizoi një trajnim një ditor, me qëllim rritjen e kapaciteteve të organizatave aktive të shoqërisë civile në mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe dhënien e ndihmës juridike për grupet vulnerabël. Për më shumë : [ARTIKULL](#) dhe [MANUAL](#)

KShH, duke patur parasysh se shkëljet e konstatuara janë të përsëritura dhe me pasoja, i sugjeron Ministrisë së Drejtësisë, të ndërhyjë për përmirësimin e situatës.

KShH i sugjeron gjithashtu organit të Prokurorisë, që me nismën e vet, të iniciojë procedimin penal për “trajtim çnjerëzor dhe poshtërues”, parashikuar nga neni 86, gërma d) K.Penal.

SHËNDETI MENDOR

Njoftim për iniciimin e sesioneve monitoruese në Spitale/Pavione Psikiatrike, me qëllim verifikimin e kushteve, trajtimit dhe respektimit të të drejtave të personave që vuajnë nga çrregullime të shëndetit mendor



NJOFTIM

Në kuadër të rikonfirmimit të Marrëveshjes së Bashkëpunimit ndërmjet Komitetit Shqiptar të Helsinkit dhe Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, "Në fushën e të drejtave shëndetësore të shtetasve, në institucionet e kujdesit shëndetësor", njoftojmë iniciimin e sesioneve monitoruese në Spitale/Pavione Psikiatrike, me qëllim verifikimin e kushteve, trajtimit dhe respektimit të të drejtave të personave që vuajnë nga çrregullime të shëndetit mendor

Këto misione monitoruese realizohen në kuadër të Projektit “Të litigojmë në mënyrë strategjike për mbrojtje efektive të të drejtave në fushën e shëndetit”, mbështetur financiarisht nga Fondacioni Shoqëria e Hapur për Shqipërinë



“Gjendje e rëndë e personave me probleme të shëndetit mendor në sistemin e burgjeve”

Në Spitalin e Burgjeve (IVSHB), situata paraqitet tepër shqetësuese. Kapaciteti i institucionit është 99 persona, ndërsa në fakt të akomoduar ishin 112 persona, domethënë 13 persona mbi kapacitet. 92 persona vuajnë nga çrregullime të shëndetit mendor, prej të cilëve, 34 personave janë me masën e sigurimit “Shtrim i përkohshëm”, 54 persona janë me masë mjekësore “Mjekim i detyruar”, dhe 4 persona të paraburgosur që vuajnë nga sëmundje të ndryshme. Mbipopullimi në këtë institucion u konstatua në disa dhoma të tij, ku ishin vendosur deri në 5 persona, ku 1-2 persona flinin në dyshe me sfungjerë. Ndërsa në një dhomë me sipërfaqe rreth 14m² qëndronin 7 persona, 3 prej të cilëve në sfungjer përdhe. Vlen të përmendet se sfungjerët dhe shtrojat në dhoma ishin të keqpërdorura dhe të ndotura. Për më tepër r: [ARTIKULL](#)



KShH më datë 14 qershor 2018 organizoi Konferencë Përmblylëse: “Prezantimi i gjetjeve dhe konkluzioneve të nxjerra nga monitorimi i procesit të vetting-ut”. Për shkak të rëndësisë dhe volumit që ka procesi i vettingut, ku priten të rivlerësohen në mënyrë kalimtare rreth 800 subjekte, KShH është i ndërgjegjshëm se ky proces është kompleks dhe i vështirë. Megjithatë, KShH vlerëson se ky volum i lartë pune kërkon një veprimtari me ritëm më të shpejtë dhe dinamik nga institucionet e pavarura kushtetuese të vettingut, por pa e cenuar cilësinë e vettingut. Lexo: [Raport](#)

PROCESI I VETTINGUT

DSIK I HAP RRUGË TRANSPARENCËS PËR TË DHËNAT E KËRKUARA PËR FIGURËN E SUBJEKTEVE NË KUADËR TË VETTINGUT

Në datën 5 Shkurt 2018, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale me kërkesë të KShH-së, ka dhënë vendim për tre organet ndihmëse të vettingut, ku dy prej tyre, përkatësisht për DSIK dhe ILDKPKI urdhërohen të vendosin në dispozicionin e KShH-së informacionin e kërkuar statistikor. DSIK ka ankimuar në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, vendimin e Komisionerit, ku KShH ka ndërhyrë si Person i Tretë në këtë proces. Në dt. 18.06.2018, Gjykata ka vendosur rrëzimin e Kërkesë-padisë së DSIK duke e lënë në fuqi vendimin e Komisionerit. Shih: [Artikull](#)



“Helsinki” kritika Prokurorisë: Asnjë i hetuar nga të shkarkuarit e Vettingut

Sipas K.Pr.Penale, kur organet administrative siç është KPK, gjatë hetimit administrativ shikojnë fakte apo rrethana që përbëjnë vepër penale kanë detyrimin të bëjnë referimin e materialeve në organin e prokurorisë. Nga informacioni i marrë nga Prokuroritë e Rretheve Gjyqësore, na ka rezultuar vetë m 1 rast i referuar nga ana KPK-se, për një prej subjekteve prioritare, për të cilin Prokuroria ka vendosur “Mos fillim të hetimeve”... Për më tepër: [Interviste](#)

SHOQËRIA CIVILE KUNDËR EKSTREMIZMIT TË DHUNSHËM

FENOMENI I EKSTREMIZMIT TË DHUNSHËM, TERRORIZMIT DHE RADIKALIZMIT

Vijon puna edhe gjatë ditës së dytë për hartimin e **'Protokollit kundër ekstremizmit të dhunshëm në burgje'** ku punonjës nga burgje të ndryshme me asistencën e z. Jack Burger, Ekspert ndërkombëtar i luftës kundër ekstremizmit të dhunshëm, po hartojnë draftin e parë të këtij protokollit që do të bëjë unifikimin e praktikës së ndjekjes së rasteve të lidhura me fenomenin e ekstremizmit të dhunshëm në burgje.

Komiteti Shqiptar i Helsinkit organizoi në Fakultetin e Shkencave Sociale të Universitetit të Tiranës forumin e diskutimit me studentët rreth fenomenit të ekstremizmit të dhunshëm, terrorizmit dhe radikalizmit. Shih: [Artikull](#)



Sot në Universitetin Aleksandër Moisiu në Durrës, me studentë të Fakultetit të Drejtësisë, Shkencave Politike dhe Komunikimit për të diskutuar rreth perceptimeve të ndryshme që ata kanë për çështje që lidhen me fenomenin e ekstremizmit të dhunshëm, radikalizmin apo terrorizmin në forumin përmblylës të vitit akademik. Për më shumë: [Artikull](#)



Komiteti Shqiptar i Helsinkit organizoi me datë 6 qershor, me studentë të Universiteti Europian të Tiranës, forumin “Ekstremizmi i dhunshëm, sfida madhore e kohës sonë”. Më shumë: [Artikull](#)



GRUPET VULNERABËL

RESPEKTIMI I TË DREJTAVE TË AZILKËRKUESVE DHE EMIGRANTËVE NË SHQIPËRI

STUDIMI I KSHH : SHQIPËRIA S'MUND
T'I PËRBALLOJË EMIGRANTËT

“Shqipëria duhet të marrë masa konkrete për zgjidhjen e problemeve si papunësia, varfëria dhe pasiguria, për të reduktuar numrin e shqiptarëve që kërkojnë azil në vendet evropiane”, është ky përfundim i studimit të Komitetit Shqiptar të Helsinkit, në lidhje me çështjet e migrimit dhe azilit. Sipas këtij studimi, qeveria shqiptare nuk ka arritur të gjejë një zgjidhje, e cila të jap rezultate konkrete në menaxhimin e largimit masiv të shqiptarëve nga vendi. Në këto 25 vite, janë larguar nga Shqipëria rreth 33% e shqiptarëve, ndërkohë, largimin më të madh vendi ynë e ka njohur vitet e fundit. Sipas studimit, renditeti ndër vendet e para për nga numri i kërkesave për azil, të krahasueshëm me vendet që janë në luftë. Por, pavarësisht kërkesave të larta, vendet evropiane pranojnë shumë pak shqiptarë për t'i njohur ata si azilant. Sipas raportit, numri i shqiptarëve që janë pranuar si azilant në këto vite, ka qenë më pak se 1%, ndërsa kërkesat, në çdo vit, këto 5 vitet e fundit, kanë qenë me mijëra. Për më shumë: [Artikull](#)



Në vijim të projektit 'Kontribut më të mirë për respektimin e të drejtave të azilkërkuesve dhe refugjateve në Shqipëri', të zbatuar gjatë periudhës Tetor 2016-Janar 2018 me mbështetjen financiare të Ambasadës së Vendeve të Ulëta në Tiranë, KShH realizoi një mision monitorimi në **Pikën e Kalimit Kufitar Qafë Botë, Stacionin e Policisë në Livadhja që mbulon Pikën e Kalimit të Kufirit në Rips, Komisaratin e Kufirit dhe Emigracionit Sarandë dhe Pikën e Kalimit Kufitar Kakavijë.**



Ky buletin është përgatitur në kuadër të projektit “Përmirësimi i situatës të të drejtave të njeriut në Shqipëri nëpërmjet forcimit të shtetit të së drejtës – Klinika ligjore XII”, zbatuar nga Komiteti Shqiptar i Helsinkit dhe mbështetur financiarisht nga organizata Civil Rights Defenders, me fonde të Qeverisë së Mbretërisë Suedeze.



Përmbajtja e këtij bulletini është përgjegjësi e plotë e Komitetit Shqiptar të Helsinkit dhe nuk reflekton qëndrimin e Qeverisë Suedeze ose të organizatës Civil Rights Defenders.

Gjetjet dhe çështjet e publikuara në këtë buletin u mundësuan nga: Fondacioni Shoqëria e Hapur për Shqipërinë, Ambasada e SHBA-ve në Shqipëri, Civil Rights Defenders, Komisioni Evropian, Open Society Institute - Budapest, Ambasada e Vendeve të Ulëta në Shqipëri, Ambasada e Britanisë së Madhe, ERRC European Roma Right Community, Komiteti Holandez i Helsinkit, Bank E atch etj.

Adresa: Rr. “Brigada e VIII”, Pall TeknoProjekt, Ap.10, Kati 6 Tiranë-Shqipëri

Kutia Postare Nr. 1752, Tel: ++355 (0)4 233671, e-mail: office@ahc.org.al, web adresa: www.ahc.org.al